

## **PROGRAMI I TRANSPARENCËS**

### **PËR KOMISIONIN E PAVARUR TË KUALIFIKIMIT**

#### **I. HYRJE**

Në përputhje me ligjin nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, nenit 7 të ligjit nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit" (LDI) dhe "Programit Model të Transparencës" miratuar me Urdhrin nr. 14, datë 22.01.2015 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, është përgatitur programi i transparencës për Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Nëpërmjet këtij programi synohet që Komisioni i Pavarur i Kualifikimit të ndërtojë dhe rrisë transparencën gjatë procesit për rivlerësimin kalimtar të të gjithë subjekteve të rivlerësimit. Programi i transparencës do të përditësohet periodikisht, në përputhje me nenin 5 të LDI-së. Informacioni i publikuar në këtë program, synon të bëjë transparencën e veprimtarisë së punës së këtij institucioni nëpërmjet pasqyrimit të detajuar në faqen zyrtare kpk.al.

Programi i transparencës pasqyrohet në rubrika, tekste/përmbajtje, afat kohor për bërjen publike të tij, mënyrën e bërjes publike si dhe strukturën e cila prodhon ose administron dokumentin. Në përmbajtje të tij evidentohet skema e publikimit, e cila pasqyron menutë ku adresohet dokumenti në faqen zyrtare në internet. Përveç kësaj, çdo dokument është i aksesueshëm edhe në skemë.

Në rubrikat e faqes zyrtare pasqyrohen edhe informacione që karakterizohen nga kufizime të identifikimit të të dhënave personale për shkak të ruajtjes së privatësisë së individëve/subjekteve të të dhënave, etj.

Skema e publikimit paraqitet nëpërmjet tabelës përmbledhëse të evidentuar në këtë program.

#### **II. PARIME TË PËRGJITHSHME**

Parimet kryesore në të cilat mbështetet Programi Transparencës së KPK-së janë:

1. "E drejta për informim" është e drejtë Kushtetuese e parashikuar në nenin 23 të saj, e aksesueshme nga të gjithë pa asnjë përjashtim.
2. Prezumimi i publikimit maksimal të të dhënave: KPK-ja ushtron funksione publike, për rrjedhojë informacioni që rrjedh nga veprimtaria e tij publikohet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

3. Zbatimi korrekt i Kushtetutës, ligjit dhe dispozitave ligjore që rregullojnë në mënyrë të posaçme veprimtarinë e KPK-së, nr 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
4. Informacioni përshatet në gjuhë të qartë e të kuptueshme.
5. Organ mbikëqyrës i procedurave të informimit publik është Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
6. Rishikimi i programit të transparencës bëhet sipas së njëjtës procedurë, përmes së cilës është bërë miratimi i tij.
7. Informacioni publik pa kërkesë duhet të jetë:
  - i plotë;
  - i saktë;
  - i përditësuar;
  - i thjeshtë në konsultim;
  - i kuptueshëm;
  - lehtësisht i aksesueshëm;
  - i pajtueshëm me dokumentet origjinale në posedim të autoritetit publik.

### **III. INFORMACIONI QË BËHET PUBLIK PA KËRKESË**

Informacioni i lejuar për publikim është shprehimisht i parashikuar në nenin 7 të ligjit nr. 119/2014.

Në përputhje me këtë program transparence të miratuar, institucioni vendos në dispozicion të publikut në faqen e tij të internetit [kpk.al](http://kpk.al), kategoritë e mëposhtme të informacionit:

- Strukturën organizative të autoritetit publik;
- Tekstet e plota, të konventave që janë ratifikuar, të ligjeve, të akteve nënligjore, të kodeve të sjelljes, dokumente politikash, të manualit ose ndonjë dokument tjetër që ka lidhje me ushtrimin e funksioneve të tij dhe që prek publikun e gjerë;
- Informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitim të kërkesave për informim, si dhe procedurat e ankimit të vendimit përkatës;
- Të dhëna për vendndodhjen e zyrave të institucionit, orarin e punës, emrin dhe kontaktet e koordinatorit për të drejtën e informimit;
- Të dhëna për arsimin, kualifikimet dhe pagat e funksionarëve, të cilët kanë detyrimin për deklarimin e pasurisë, sipas ligjit, strukturat e pagave për nëpunësit e tjerë, si dhe një përshkrim të procedurave të zgjedhjes, kompetencave dhe procedurën që ata ndjekin për të marrë vendime;
- Mekanizmat monitorues dhe të kontrollit që veprojnë mbi autoritetin publik, përfshirë planet strategjike të punës, raportet e auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose subjekte të tjera, si dhe dokumentet që përmbajnë tregues të performancës së autoritetit;

- Të dhëna për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar në vijim si dhe çdo raport vjetor për zbatimin e buxhetit;
- Informacion për procedurat e prokurimit duke përfshirë: listën e kontratave të lidhura, shumën e kontraktuar, palët kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve apo mallrave të kontraktuara, informacionin për zbatimin dhe monitorimin e kontratave;
- Informacion për shërbimet që autoriteti i jep publikut, përfshirë standardet për cilësinë e shërbimit, informacione dhe dokumente që kërkohen shpesh, çdo informacion tjetër që gjykohet i dobishëm nga autoriteti publik;
- Çdo mekanizëm dhe procedurë për bërjen e kërkesave dhe ankesave, në lidhje me veprimet ose mosveprimet e autoritetit publik, procedura, përmes së cilës personat e interesuar mund të paraqesin mendimet e tyre apo të ndikojnë në çfarëdo mënyre tjetër në hartimin e ligjeve, të politikave publike apo ushtrimin e funksioneve të AP-së, si dhe të kategorive të informacionit që bëhet publik pa kërkesë;
- KPK-ja, gjithashtu, krijon dhe arkivon një kopje digjitale të faqes zyrtare të tij në internet, të plotësuar me informacionin që kërkohet në programin e miratuar të transparencës, si dhe për metodat, mekanizmat dhe periodicitetin e publikimit të informacioneve publike, të cilat vihen në dispozicion të publikut pa kërkesë;
- Aktet që përmbajnë rregulla, norma apo kufizime të të drejtave dhe lirive themelore të individit, si dhe me efekt të drejtpërdrejtë për ta, bëhen publike me anë të postimit në faqen zyrtare të internetit, brenda 48 orëve prej miratimit të aktit nga AP-ja.

Informacioni i publikuar sipas kësaj skeme, përditësohet sa herë ai ndryshon.

#### IV. TABELA PËRMBLEDHËSE E PROGRAMIT TË TRANSPARENCËS SË KPK

Kategoritë e informacionit publik pa kërkesë	Baza ligjore	Dokumenti ose përmbajtja	Afati kohor për publikim	Mënyra e publikimit	Struktura përgjegjëse për përgatitjen e materialit apo disponimin e tij
Përshkrimi i strukturës organizative	Neni 7/1/a i ligjit nr. 119/2014	Vendimi i Kuvendit nr. 93/2017 “Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të KPK”  Skemë	Menjëherë pas botimit në Fletoren Zyrtare	Në faqen zyrtare në menunë <u>“Rreth nesh”</u>	Drejtoria Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse/ specialisti i burimeve njerëzore.

Përshkrimi i funksioneve dhe detyrave të autoritetit publik	Neni 7/1/a i ligjit nr. 119/2014	Tabelë e funksioneve, detyrave dhe kompetencave të drejtorëve/ive dhe strukturave përbërëse.	Menjëherë pas botimit në Fletoren Zyrtare	Në faqen zyrtare në menunë “ <u>Rreth nesh</u> ”	Drejtoria Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse/ Specialisti i burimeve njerëzore.
Akte ndërkombëtare; Ligje; Akte nënligjore; Dokument tjetër që lidhet me ushtrimin e funksioneve të institucionit.	Neni 7/1/b i ligjit nr. 119/2014	Ligje Akte nënligjore  Vendime të titullarit të institucionit  Rregullore të brendshme	Menjëherë pas botimit në Fletoren Zyrtare  Menjëherë pas urdhrin të miratimit nga Kryetari/Komision erët	Në faqen zyrtare në menunë “ <u>Legjislacioni</u> ”  Në faqen zyrtare në menunë “ <u>Legjislacioni</u> ”	KPK dhe institucione të tjera
Informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim, si dhe procedurat e ankimit të vendimit	Neni 7/1/c/g i ligjit nr. 119/2014	Format denoncimi  Format kërkesë  Format ankese  Informacione <sup>1</sup>  Adresa: Rruga e Kavajës, ish-godina e ish-“Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve”, Tiranë Orari: E hënë – E Premte, ora 12:00-14:00 Adresë e-mail: <a href="mailto:info@kpk.al">info@kpk.al</a>	Menjëherë pas miratimit të Programit të Transparencës  Menjëherë në rast ndryshimesh	Në faqen zyrtare në menunë “ <u>Model denoncimi</u> ”  Në faqen zyrtare në menunë “ <u>E drejta për informim - Procedura për informim</u> ”  Në faqen zyrtare në menunë “Programi i Transparencës”, pika “ <u>Informacione</u> ”	Drejtoria e Menaxhimit të Çështjeve dhe Marrëdhënieve me Publikun/ koordinatori për median dhe marrëdhëniet me jashtë

<sup>1</sup> Këtu të përfshihen informacione për mënyrën e paraqitjes së kërkesave, denoncimeve, ankesave etj.

<p>Të dhëna për vendndodhjen e zyrave të autoritetit publik, orarin e punës, emrin dhe kontaktet e koordinatorit për të drejtën e informimit</p>	<p>Neni 7/1/ç i ligjit nr. 119/2014</p>	<p>Rruga e Kavajës, ish- godina “Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve”, Tiranë</p> <p>Orari i punës: E hënë – e Premte, ora 08:30 – 17:00</p> <p>Koordinatori për të drejtën e informimit</p> <p>(kontaktet):</p> <p>Nr. tel ....</p> <p>Adresë e-mail: ...</p>	<p>Menjëherë pas miratimit të urdhrin të caktimit të koordinatorit</p>	<p>Në faqen zyrtare në menunë “<u>Adresa dhe kontakte</u>”</p>	<p>Drejtoria e Menaxhimit të Çështjeve dhe Marrëdhënieve me Publikun/ koordinatori për median dhe marrëdhëniet me jashtë</p>
<p>Të dhëna për arsimimin, kualifikimet dhe pagat e funksionarëve, të cilët kanë detyrimin për deklarimin e pasurisë</p> <p>Strukturat e pagave për nëpunësit e tjerë</p> <p>Përshkrim i procedurave të zgjedhjes, kompetencave</p>	<p>Neni 7/1/d i ligjit nr. 119/2014</p>	<p>Të dhëna për kualifikimet e komisionerëve;</p> <p>Të dhëna për kualifikimet e këshilltarëve ligjorë dhe këshilltarëve ekonomikë;</p> <p>Vendimi i Kuvendit nr. 93/2017 “Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit” ;</p> <p>Vendimi i Kuvendit nr. 82/2017 “Për miratimin e listës</p>	<p>Menjëherë pas botimit në Fletoren Zyrtare</p>	<p>Në faqen zyrtare në menunë “<u>Rreth nesh</u>”</p> <p>Në faqen zyrtare në menunë “<u>Rreth nesh</u>”</p>	<p>Drejtoria Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, specialisti i burimeve njerëzore</p>

dhe detyrave të funksionarëve të lartë dhe procedura që ata ndjekin për të marrë vendime.		<p>në bllok të kandidatëve të zgjedhur të institucioneve të rivlerësimit sipas ligjit nr. 84/2016”;</p> <p>Vendimi nr. 1, datë 10.11.2017, i Komitetit Ad Hoc pranë KPK-së për pranimin e këshilltarëve ekonomikë pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit;</p> <p>Vendimi nr. 2, datë 18.11.2017, i Komitetit Ad Hoc pranë KPK-së për pranimin e këshilltarëve ligjorë pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit;</p> <p>Përshkrim/dispozitat e ligjit nr. 84/2016. (neni 6)<sup>2</sup> (neni 22)<sup>3</sup> (Kreu III)<sup>4</sup></p>			
Mekanizmat monitorues; raporte auditivi; dokumentet me tregues performance	Neni 7/1/ dh i ligjit nr. 119/2014	Raporte monitorimi dhe auditimi.(KLSH)	Menjëherë pas depozitimit në KPK ose publikimit në faqen zyrtare të autoritetit monitorues.	Në faqen zyrtare në menunë “ <u>Publikime</u> ”	Drejtoria Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, specialisti i financës

<sup>2</sup> Neni 6 i ligjit 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në të cilin parashikohen kriteret e zgjedhjes së anëtarëve të institucioneve të rivlerësimit.

<sup>3</sup> Neni 22 i ligjit 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në të cilin parashikohen kriteret që duhen përmbushur për t’u zgjedhur si këshilltar ligjor ose ekonomik.

<sup>4</sup> Kreu III i ligjit 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në të cilin parashikohet organizimi dhe funksionimi i institucioneve të rivlerësimit.

Buxheti; Plani financiar për vitin financiar në vijim	Neni 7/1/e i ligjit nr. 119/2014	Buxheti Raporte	Menjëherë pas miratimit të ligjit të buxhetit.	Në faqen zyrtare në menunë “ <u>Rreth nesh- Buxheti/prokurimet</u> ”	Drejtoria Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, specialisti i fiancës
Informacion për procedurat e prokurimit	Neni 7/1/ë i ligjit nr. 119/2014	Rregjistri i parashikimit të prokurimeve	Menjëherë pas dërgimit në APP	Në faqen zyrtare në menunë “ <u>Rreth nesh – Buxheti/prokurimet</u> ”	Drejtoria Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, specialisti i fiancës
Shërbimet e autoritetit për publikun	Neni 7/1/f i ligjit nr. 119/2014	Regjistri i denoncimeve <sup>5</sup>	Përditësohet periodikisht	Në faqen zyrtare në menunë “ <u>E drejta për informim-Regjistra</u> ” <sup>6</sup>	Drejtoria Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, specialisti i pritjes me popullin;
Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve	Neni 7/1/i; Neni 8 i ligjit nr.119/2014	Regjistri i kërkesave për informacion Regjistri i ankesave			Koordinatori për të drejtën e informimit
Paraqitja e mendimeve në hartimin e p/akteve etj.	Neni 7/1/gj i ligjit nr. 119/2014	P/akt ligjor dhe nënligjor  P/strategji	Menjëherë pas hartimit të projektaktit/projekt strategjisë	Në faqen zyrtare në menunë “ <u>Publikime - Njoftimi për konsultim publik</u> ”	Drejtoria e Menaxhimit të Çështjeve dhe Marrëdhënieve me Median dhe Publikun
Mbajtja e dokumentacionit nga KPK	Neni 7/1/h i ligjit nr. 119/2014	Tabelë <sup>7</sup>	Pas miratimit të tabelës <sup>8</sup>	Në faqen zyrtare në menunë	Drejtoria Ekonomike dhe

<sup>5</sup> Të dhënat që do të publikohen në këtë rubrikë nuk duhet të përmbajnë të dhëna identifikuese për denoncuesin apo subjektin e rivlerësimit për të cilin bëhet denoncimi. Të dhënat të jenë vetëm statistikore.

<sup>6</sup> Pranë secilit regjistër që do të publikohet, do të vendoset shënimi përkatës që shpjegon për publikun arsyen përse të dhënat e publikuara janë vetëm numerike, duke bërë një përshkrim të shkurtër të detyrimeve që burojnë nga ligji “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

<sup>7</sup> Tabela do të përmbajë të dhëna mbi llojet e dokumentacionit që ruhet në KPK, vendin ku mbahet dhe ligjin sipas të cilit trajtohet.

<sup>8</sup> Pranë tabelës të vendoset një shënim ku të sqarohet publiku përse në një kategori të caktuar të informacionit nuk mund të aksesojë për shkak të ligjit për informacionin e klasifikuar.

				“Programi i Transparencës - Informacione”	Shërbimeve Mbështetëse Specialisti i Arkiv/Protokolli t
Informacione dhe dokumente që kërkohen shpesh	Neni 7/1/k i ligjit nr. 119/2014	Të dhëna statistikore  <a href="#">Modeli</a> i denoncimit	Përditësohet periodikisht  Menjëherë pas miratimit të modelit.	Në menunë “ <a href="#">E drejta e informimit - Informacione dhe dokumente që kërkohen shpesh</a> ” .	Drejtoria e Menaxhimit të Çështjeve dhe Marrëdhënieve me Median dhe Publikun, koordinatori për median dhe marrëdhëniet me jashtë.
Informacione të tjera të dobishme	Neni 7/1/l i ligjit nr. 119/2014	Mbrojtja e të dhënave personale <sup>9</sup> .  Materiale ndërgjegjësuese  Evente	Menjëherë pas miratimit nga Mbledhja e Komisionerëve	Në faqen zyrtare “ <a href="#">E drejta e informimit - Informacione</a> ”  Në faqen zyrtare në menunë “ <a href="#">Publikime - Evente</a> ”	Drejtoria e Menaxhimit të Çështjeve dhe Marrëdhënieve me Median dhe Publikun, koordinatori për median dhe marrëdhëniet me jashtë

## V. PUBLIKIMI

Në përputhje me këtë program transparence të miratuar, AP-ja vendos në dispozicion të publikut në faqen e tij të internetit [kpk.al](http://kpk.al) dhe në mjediset e pritjes së publikut, kategoritë e mësipërme, në një menu të veçantë të titulluar “Programi i Transparencës”.

## VI. MONITORIMI

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale monitoron zbatimin e LDI, duke nxitur parimin e transparencës në punën e autoriteteve publike, veçanërisht duke sensibilizuar dhe informuar për çështje të së drejtës së informimit.

<sup>9</sup> Në këtë menu mund të bëhet një përshkrim në linkun përkatës “Informacione”, ku të përshkruhet shkurtimisht për publikun kuadri ligjor nga i cili rrjedhin detyrimet për KPK-në, për të ruajtur dhe për të mos bërë publik një kategori të caktuar të informacionit.



Komisioneri bën rekomandime për autoritetet publike, lidhur me konceptimin dhe zbatimin e programeve institucionale të transparencës.